



REPUBLIKA E SHQIPËRISË  
MINISTRIA E TURIZMIT, KULTURËS, RINISË DHE SPORTEVE  
KËSHILLI KOMBËTAR I RESTAURIMEVE

Nr. 56 Prot

Tiranë, më 12.05, 2010

**VENDIM Nr. 2 dt. 04.05.2010**

Në mbështetje të nenit 17, pika 6, të ligjit nr. 9048, datë 07.04.2003, ndryshuar me ligjin nr. 9882, dt 28.02.2008, "Për Trashëgiminë Kulturore", Këshilli Kombëtar i Restaurimeve në mbledhjen e datës 04.05.2010, pasi shqyrtoi projektet e diskutuara në Institutin e Monumenteve të Kulturës,

**VENDOSI:**

Sipas pikave të rendit të ditës:

**I. Lidhur me: Diskutimi i projekteve të financuara nga buxheti i shtetit:**

1. **Miratohet:** Projekt restaurimi banesa e Hysen Kazani, Tiranë. (Të verifikohet pronësia e banesës katër katëshe ngjitur me monumentin. Në rast se banesa është pa leje, ti dërgohet një shkresë Inspektoriatit Ndërtimor Tiranë, Bashkisë Tiranë dhe zyrës së ALUIZNIT, Tiranë, për moslegalizimin e objektit, si dhe prishjen e tij, pasi çënon integritetin e monumentit)
2. **Miratohet:** Projekt ndërhyrje restauruese në fazën e tretë të punimeve në Kishën e Shën Kollit, Mesopotam.
3. **Miratohet:** Punime restaurimi Kalaja e Grazhdanit, Dibër. (Vazhdim punimesh).
4. **Miratohet:** Projekt rindërtimi i murit të shembur Kalaja Peqin.
5. **Miratohet:** Projekt restaurimi banesa Galanxhi, Gjirokastër.
6. **Miratohet:** Projekt restaurimi banesa Çuberi, Gjirokastër
7. **Miratohet:** Projekt restaurimi banesa Fico, Gjirokastër
8. **Miratohet:** Projekt restaurimi banesa Kokobobo, lagja "Palorto", Gjirokastër.
9. **Miratohet:** Projekt restaurimi banesa Ramize Vehbi, lagja "Pazari i Vjetër", Gjirokastër.
10. **Miratohet:** Projekt restaurimi, konservimi, konsolidimi dhe mirëmbajtje e pamjes së jashtme arkitektonik të ansambllit të lagjes "Mangalem" (e pjesshme 16 banesa), Berat

**II. Lidhur me: Diskutimi i projekteve të cilat presin financim nga buxheti i shtetit:**

1. **Nuk u diskutua:** Projekti i konservimit të ikonës së "Shën Kozmait", në DRKK Berat

2. **Miratohet:** Projekt – ide (Miratimi në parim i problematikave të mozaikut të fasadës së Muzeut Kombëtar Tiranë).
3. **Miratohet:** Restaurim i mozaikut në Bazilikën “D”, Bylis.
4. **Miratohet:** Ndërrhyrjet konservuese në mozaikun e narteksit, bazilika A Bylis.

### **III. Lidhur me: Diskutimi i kërkesave për licensë**

1. **Miratohet kërkesa:** Shoqëria “NDËRTUESI 1”, kërkesë për pajisje me licensë të kategorisë C, me drejtues teknik Adelina Baballëku.
2. **Miratohet kërkesa:** Shoqëria “EPIDAMNOS”, kërkesë për pajisje me licensë të kategorisë C, me drejtues teknik Lida Miraj.
3. **Miratohet kërkesa:** Shoqëria “G&XH”, kërkesë për pajisje me licensë të kategorisë C, me drejtues teknik Genc Samimi.
4. **Miratohet:** Kërkesë e Prof. Dr. Valter Shtyllës, për pajisje me licensë personale profesionale të Kat. A, A/1, A/2, A/3, A/4.
5. **Pezullohet:** Kërkesë për rinovim licensë e ark. Reshat Gega, për licensë personale profesionale të Kat. A, A/2, A/3, A/4.
6. **Pezullohet:** Kërkesë për rinovim licensë e shoqërisë “GEN RED”, për licensë profesionale, shoqëri ndërtimi, për Kat. C, me drejtues teknik, Reshat Gega.

- Ngarkohet sekretaria teknike, për njoftimin e këtij vendimi.
- Ngarkohet Qendra Kombëtare e Inventarizimit të Pasurisë Kulturore për regjistrimin e këtij vendimi.
- Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

**K R Y E T A R**  
**FERDINAND XHAFERRAJ**

**SEKRETAR I KKR**  
**PROF. DR. VALTER SHTYLLA**